

mentuese e bindëse, sidomos sa i përket aspekteve të brendshme të këngëve të punës, të këngëve të kurbetit, atyre të humorit, të kapuçave si dhe ndaj grupit të veçantë të këngëve që këtu me të drejtë janë pagëzuar *Këngë të ndryshme popullore*. Gjithashtu edhe ndarja, klasifikimi në pesë lloje këngësh të përfshira në

këtë ble, marrë në tërësi është respektuar.

Vëllimi *Këngë të ndryshme popullore* përmban kryesisht lëndë deri tash të pabotuar, prandaj është me interes dhe paraqet kontribut të rëndësishëm për folkloristikën tonë.

ADEM ZEJNULLAHU

**Dr. Fazli Syla, POEZIA POPULLORE SHQIPTARE E KAÇAKËVE, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1982.**

Studimi monografik i dr Fazli Sylës „*Poezia popullore shqiptare e kaçakëve*” është vepra e parë e folkloristikës shqiptare që trajton çështjen e një zhanri të poezisë popullore, si edhe studimi i parë nga fusha e folklorit, që po e boton Instituti Albanologjik. Kjo vepër trajton një problematikë interesante, sepse në mënyrë të shumanshme e ndriçon reflektimin e lëvizjes së kaçakëve në poezinë tonë historike, duke e përcjellë dukurinë e kaçakërisë që nga zanafilla e deri në prag të Luftës së Dytë Botërore. Interesimi i autorit të këtij studimi ka pikënisje të dyanshme: e para, që nëpërmjet këngës popullore t'i zbërthejë komponentet sociale, politike, historike, kombëtare dhe moralo-etike të dukurisë së kaçakërisë në planin e gjerë historik të tri periudhave të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar dhe, e dyta, ta studiojë strukturën poetike të këngëve të kaçakëve. Vlen të theksohet që në fillim se autori e ka vështruar lëndën e studimit të vet edhe nga një aspekt shumë i rëndësishëm, në relacionin krahasimtar me këngët e popujve të tjerë të Ballkanit, të cilat u kushtohen lëvizjeve të ngjashme të popujve të tyre në periudha të caktuara të marrëdhënieve shoqërore të kushtëzuara nga rrethanat historike të kohës.

Libri i dr Fazli Sylës bashkë me *hyrjen* ka gjashtë kaptina dhe gjithsej 190 faqe. Në hyrje autori, përveç përkufizimeve të caktuara lidhur me lëvizjen e kaçakëve si formë e rezistencës kundër shfrytëzimit social dhe shtypjes kombëtare, flet edhe për shtrirjen territoriale dhe kohore të këngëve të kaçakëve duke përcaktuar edhe periudhat historike të

lëvizjes dhe lidhjet e saj me lëvizjen e përgjithshme kombëtare dhe luftën e popullit tonë për liri gjatë shekullit XIX dhe në katër dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX. Në këtë pjesë të studimit autori, duke u nisur nga qëllimi i studimit të tij, jep edhe disa sqarime lidhur me përparësitë e metodologjisë, e cila zbatohet për studimin e kësaj problematike të rëndësishme për kulturën shpirtërore të popullit tonë.

Kaptina e dytë e librit i kushtohet gjenezës së këngëve popullore të kaçakëve. Në fillim paraqiten kushtet ekonomiko-shoqërore të periudhës së sundimit osman, kur lëvizja e kaçakëve, si formë e vazhdimësisë së rezistencës kundër sundimit të huaj, kishte pikënisje nga rebelimi individual kundër shfrytëzimit të pamëshirshëm të shtresave të gjera të fshatarësisë shqiptare. Në bazë të kronologjisë autori e trajton edhe periudhën e mëvonshme dhe aspektet historike e sociale të lëvizjes së kaçakëve në vitet 1912—1941, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në reflektimin e kushteve të vështira të shtypjes kombëtare të popullësisë shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera nën sundimin e Jugosllavisë së Vjetër për vazhdimësinë e kaçakërisë deri në vitin 1941. Duke u bazuar në aspektet historike dhe sociale të lëvizjes dhe të transponimit të saj artistik në këngët popullore, autori e zbërthen shkallëzimin e rezistencës kundër sundimit të huaj duke filluar nga rebelimi i individëve kundër shfrytëzimit feudal, organizimi i grupeve të kaçakëve dhe veprimi i tyre në radhët e kryengritjeve të përgjithshme popullore e deri te pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e kaçakëve në

luftën për çlirimin kombëtar. Pjesët e veçanta të kësaj kaptine i kushtohen edhe formave të organizimit të kaçakëve, si edhe karakteristikave të veçanta sociale dhe nacionale të organizimit të rezistencës së tyre si lëvizje që gëzonte përkrahjen e gjerë të popullsisë.

Kaptina e tretë e studimit i kushtohet tematikës dhe personazheve të këngëve të kaçakëve. Konsiderojmë se autori ka vepruar drejt kur këto çështje i ka shikuar në aspektin kronologjik, sepse tematika e këngëve, në radhë të parë, e pastaj edhe disa nga veçoritë e personazheve të tyre, janë të lidhura ngushtë me periudha të caktuara të historisë së popullit tonë. Kështu në këngët e kaçakëve të periudhës së sundimit osman deri në vitet '30 të shekullit të kaluar mbizotëron tema e rebelimeve individuale të kaçakëve nga radhët e fshatarësisë kundër shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë, feudalëve vendas dhe të huaj. Personazhet e këngëve të këtilla janë fshatarë të arratisur që i sulmojnë feudalët e herë-herë e plaçkisin pasurinë e tyre për t'ua ndarë bashkëfshatarëve të vet të varfër. Disa figura të këngëve të kësaj periudhe janë ngritur deri në nivelin e heronjve të përrallave që luftojnë vetëm për qëllime mirëbërëse.

Pas viteve '30 të shekullit të kaluar, sidomos pas reformave të Tanzimatit, kur lëvizja e kaçakëve merr hov gjithnjë e më të madh, këngët popullore pasurohen me tema dhe motive të reja, sepse pasurohet baza e motivacionit të veprimit të heronjve në rrethana të reja sociale-historike, kur pushteti osman, me anë të reformave centraliste, orvatet t'i nënshtrojë popujt dhe ta forcojë pushtetin e vet edhe në viset e Ballkanit. Këngët e kësaj periudhe në të gjitha viset shqiptare trajtojnë kryesisht tri tema, që lidhen drejtpërdrejt me rrethanat e reja të kohës: kaçakërinë si rezultat i refuzimit për të shërbyer në radhët e ushtrisë së nizamëve, konfliktet për shkak të refuzimit të pagesës së taksave dhe detyrimeve të tjera shtetërore dhe kafaytjet e kaçakëve me tagrambledhësit dhe me përfaqësuesit e tjerë të pushtetit lokal. Këngët e kësaj periudhe, siç ka konstatuar autori, i përshkon konflikti i thellë i dy botëve

antagoniste — fshatarësisë së varfër që lufton për ekzistencën e thjeshtë fizike dhe pushtetit që me dhunë dhe brutalitet përpiqet t'i zbatojë normat e sundimit feudal.

Duke trajtuar lëvizjen e kaçakëve brenda Rilindjes Kombëtare Shqiptare, dr Fazli Sylja, në studimin e vet, me argumente bindëse, e shquan karakterin social dhe liridashës të lëvizjes kombëtare shqiptare. Ai vë në dukje se lëvizja e kaçakëve në të gjitha fazat e rëndësishme të historisë së popullit tonë e në mënyrë të veçantë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, shkrihej në tërësi në luftën për çlirimin kombëtar të popullit tonë. Mirëpo, pas dështimit të kryengritjeve të përgjithshme popullore, lëvizja e kaçakëve nuk shuhej, por përkundrazi bëhej më e fuqishme, si formë e rezistencës së grupeve dhe individëve që nuk pranonin t'u dorëzoheshin organeve të pushtetit osman.

Në periudhën prej vitit 1912 deri më 1941 në këngët e kaçakëve, krahas rezistencës që kishte pikënisje sociale, autori konstaton se bëhej gjithnjë e më e theksuar komponentja kombëtare e lëvizjes, e cila, në rrethanat e Luftës së Parë Botërore, inkadrohet në tërësi në luftë kundër pushtuesve austriakë dhe bullgarë. Kjo komponente e përshkon edhe lëvizjen e kaçakëve gjatë kohës së Jugosllavisë së Vjetër, sepse kaçakët e kësaj periudhe luftojnë kundër shtypjes kombëtare, kolonizimit, çkombëtarizimit dhe shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e veta në Kosovë dhe në vise të tjera. Duke trajtuar tematikën e këngëve të kësaj periudhe, autori i ka kushtuar kujdesin e duhur edhe këngëve të kaçakëve në viset e Shqipërisë gjatë kohës së sundimit antipopullor të regjimit të Ahmet Zogut.

Në kaptinën „Komponentet moralo-etike të këngëve të kaçakëve” dr Fazli Sylja e thëllon studimin e tij duke i shkoqitur në hollësi veçoritë karakteristike, të cilat e shquajnë këtë lloj të poezisë popullore si zhanër të veçantë brenda këngëve historike të popullit tonë. Krahas analizës së hollësishme të këtyre veçorive, ai, nëpërmjet këngëve, vë në pah edhe procesin e evolucionit të botëkuptimeve të njerëzve gjatë procesit his-

torik të ngritjes dhe të rënies së hovit të lëvizjes së kaçakëve gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të saj. Në sprovat e shumta të luftës së individëve për mbrojtjen e qenies së vet, integritetit personal dhe familjar, dalin në shesh më së miri elementet karakteristike të moralit të masave popullore, virtytet e trimërisë, burrërisë, sakrificës, qëndresës dhe durimit, që janë komponente kryesore të krijimit dhe të ruajtjes së këtyre këngëve. Duke pasur për bazë një moral të këtillë, këngët e kaçakëve qëndrojnë mbi baza të forta realiste, prandaj elementet e glorifikimit të virtyteve të heronjve fare rrallë realizohen me mjete fantastike. Kështu, siç del nga këngët popullore, trimëria dhe heroizmi i kaçakut buron nga forca e vetëbesimit, nga vendosmëria për të qëndruar deri në fund, si edhe nga siguria në armët personale që në duart e kaçakut janë të pagabueshme. Duke bërë fjalë për trimërinë dhe heroizmin në këngët e kaçakëve, autori konstaton me të drejtë se në këto këngë shquhet në mënyrë të veçantë kulti i armës, që është i pranishëm në traditën e përgjithshme të krijimtarisë popullore me tematikë të luftës.

Figurat e heronjve të këngëve me të gjitha karakteristikat e tyre dalin edhe më të plota, sepse në shumë raste poeti popullor i ka konceptuar sjelljet dhe veprimet e tyre edhe në ambientin e vendlindjes dhe në raporte të ndryshme familjare e farefisnore. Mu për këtë, në shumë këngë manifestohet në mënyrë të veçantë karakteri lirik i krijimeve të këtilla, që buron nga ndjeshmëria humaniste për jetën e rëndë dhe plot vuajtje të luftëtarëve, të cilët përfaqësojnë rezistencën e përgjithshme popullore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit nga pushteti i huaj. Kjo ndjeshmëri bëhet edhe më e theksuar si pasojë e pasigurisë së përhershme dhe e parandjenjave për përfundimin tragjik të kaçakëve. Mirëpo, atmosfera tragjike e pranishme në shumicën e këngëve të kaçakëve, siç konstaton autori i studimit, i përket tragjikës heroike dhe në këngët popullore është paraqitur me krejt madhështinë e vet për t'i shquar në mënyrë të veçantë figurat e heronjve në momentin e vdekjes së tyre në fushën e nderit. Vir-

tytet heroike i karakterizojnë në shumë raste edhe figurat e tjera nga rrethi familjar i kaçakut, sidomos nënën dhe motrën e heroit.

Në këngët popullore të kaçakëve, krahas virtyteve të burrërisë, të trimërisë, të dashurisë për njeriun, të mbajtjes së besës e të tjera, që mbështeten në normat pozitive të moralit tradicional të krijuar gjatë shekujve, poeti popullor i ka paraqitur edhe veset e njerëzve. Në këto këngë është stigmatizuar sidomos tradhëtia dhe pabesia e individëve, të cilët i shfrytëzon pushtuesi i huaj për t'i zënë kaçakët. Me shembuj të spikatur nga këngët, autori i studimit i ka veçuar figurat hipokrite të tradhëtarëve nëpërmjet të cilave poeti shpreh disponimin e popullit ndaj pushtetit të huaj dhe aktit të ulët të pabesisë që shpesh maskohet nga hipokrizia fetare e figurave të hoxhallarëve e haxhinjve që betohen ose e kumbarëve dhe e njerëzve të tjerë të shitur.

Duke trajtuar aspektet moralo-etike të këngëve të kaçakëve dr Fazli Sylja sjell edhe konstatime të drejta për vlerat ideoestetike të këngëve dhe rolin e tyre për kultivimin e ndjenjave liridashëse e humanitare, për edukimin e masave popullore në frymën e idealeve të larta të luftës për drejtësi dhe barazi ndërmjet njerëzve.

Studimin monografik të dr Fazli Sylës për poezinë e kaçakëve e pasuron në mënyrë të veçantë kaptina që bën fjalë për pikëpjekjet e këtij lloji të poezisë sonë popullore me llojet e ngjashme të popujve të tjerë të Ballkanit. Këto pikëpjekje, në radhë të parë, janë pasojë e kushteve të ngjashme historiko-shoqërore të jetës së popujve të kësaj zone gjatë kohës së sundimit, si edhe e ndikimeve të ndryshme reciproke, të cilat janë të zakonshme në krijimtarinë popullore të popujve fqinj. Autori konstaton elementet e ngjashme të motiveve të daljes në arrati si kaçakë, hajdutë, kleftë, komitë e të tjerë të gjithë popujt e Ballkanit. Ai flet edhe për elementet e ngjashme në portretizimin e figurave të heronjve, madje edhe personazhet e njëjta në disa nga këngët e popujve të kësaj zone e sidomos disa heronj të përbashkët të këngëve shqiptare e serbe, e veçanërisht figurat e heronjve shqiptarë që këndohen edhe në këngët e kleft-

tëve grekë. Si veçori të përbashët të këngëve autori thekson edhe dashurinë dhe kujdesin që manifestohet në poezinë popullore të të gjithë popujve të Ballkanit për të arratisurit si luftëtarë të rezistencës popullore kundër shtypjes feudale. Në mënyrë të veçantë ai konstaton se poezia popullore shqiptare nuk i merr në gojë për të keq popujt e tjerë e as të arratisurit e tyre, sepse populli ynë i ka shikuar me simpati lëvizjet e popujve të tjerë, që përpiqeshin të çliroheshin nga Turqia. Në fund të kësaj kaptine dr Fazli Sylja vë në dukje se studimi krahasimtar i këtij lloji të poezisë mund të thellohet, por tërheq vërejtjen se nuk duhet të bëhen përgjithësime pa u vënë në pah tiparet e veçanta të këngëve të këtyre popujve.

Kaptinën e gjashtë të librit, që i kushtohet strukturës poetike të këngëve të kaçakëve, autori e ka zërit në gjashtë nënkapituj. Në fillim ai trajton veçoritë estetiko-letrare të këngëve duke u nisur nga specifikat karakteristike të kësaj poezie brenda epikës historike shqiptare. Ai konstaton se këngët e kaçakëve të disa trevave përshkohen nga elemente të theksuara lirike e herë-herë konflikti zgjidhet edhe me mjete dramatike. Njëkohësisht autori vë në dukje edhe transponimin artistik të fenomeneve estetike, sepse këngët i konsideron si formë e përqendruar e përvetësimit të realitetit të kohës, si krijime të kushtëzuara nga niveli i përgjithshëm kulturor i këngëtarëve krijues që mbartin përvojën jetësore të popullit.

Një pjesë e veçantë e kësaj kaptine i kushtohet kompozicionit të këngëve të kaçakëve. Pasi konstaton se në strukturën kompozicionale të këngëve ndikojnë faktorët e ndryshëm siç janë: mënyra e të kënduarit me karakteristika të dallueshme midis zonave në relacionin veri — jug, format muzikore, përcjellja me instrumente e të tjera, autori me shembuj konkretë i paraqet disa nga tipet e strukturave kompozicionale të këngëve të kaçakëve.

Duke shfrytëzuar përvojat pozitive të poetikës tradicionale dr Fazli Sylja trajton aspektet e veçanta të funksionit të mjeteve shprehëse artistike-stilistike. Ai me shembuj konkretë flet

për figurat më të shpeshta të këngëve të kaçakëve, duke dhënë edhe përkufizimin teorik të këtyre figurave. Duke përimtuar veçoritë e stilit dhe të figuracionit, autori në këtë pjesë të studimit flet edhe për karakteristikat gjuhësore të këtij zhanri të epikës sonë historike. Megjithëse në pjesën më të madhe të këtyre këngëve mbizotëron narracioni dhe informacioni i theshtë, gjuha poetike e këtyre krijimeve përmban nuanca të posaçme të shprehjes dhe leksik specifik, që gjithsesi ka ndikuar në pasurimin gjuhësor të letërsisë shqiptare në tërësi.

Në pjesën për metrikën e këngëve të kaçakëve autori ndalet në veçanti në karakteristikat e vargut më të shpeshtë të këngëve, në tetërokëshin trokaik dhe paraqet tipet kryesore të skemave të theksave ritmikë që zakonisht bien mbi rrokjet teke. Ai gjithashtu u kushton kujdes edhe veçorive ritmike të këngëve të Jugut, strukturës së vargjeve të dyzuara dhe funksionit të refreneve. Duke paraqitur skemat e rimave që i hasim në këngët e kaçakëve, autori flet shkurtimisht edhe për efektet e tjera ritmiko-melodike që ndikojnë në muzikalitetin e vargjeve të këtyre këngëve. Ndërkaq, kaptinën kushtuar strukturës poetike të këngëve të kaçakëve dr Fazli Sylja e përfundon me paraqitjen e mënyrës së interpretimit të këngëve në bazë të dallimeve të shënueshme të mënyrës së të kënduarit dhe llojeve të ndryshme të veglave muzikore përcjellëse, të cilat përdoren në krahina të ndryshme.

Studimi i dr Fazli Sylës „Poezia popullore shqiptare e kaçakëve” ka edhe përfundimin, ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten rezultatet e përgjithshme që dalin nga statistikimet e tij të argumentuara shkencërisht për vlerën e përgjithshme ideoestetike të kësaj poezie. Ky studim përmban edhe rezymetë e shkurtra në gjuhën frënge e serbokroate, buri met e lëndës arkivale dhe të botuar, si edhe literaturën e pasur që është përdorur për hartimin e tij.

Duke marrë parasysh rëndësinë e temës për shkencën tonë të folkloristikës, vlerën e përgjithshme të studimit, si dhe metodologjinë e shkencës marksiste, që i shikon faktet artistike në relacione të gjera social-histo-

rike të kohës dhe të faktorëve që ndikuan në krijimin e këngëve, në fund, mund të pohojmë lirisht se vepra e dr Fazli Sylës „Poezia popullore shqiptare e kaçakëve” është një kontribut i vlefshëm shkencor që ndriçon në mënyrë të shumanshme

problematikën e këngëve të kaçakëve dhe të vlerave të tyre ideoestetike dhe duhet të shërbejë si përvojë pozitive për thellimin e mëtejshëm të studimeve kushtuar poezisë popullore shqiptare me tematikë historike.

SADRI FETIU

**NINULLA, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Sadri Fetiu, Prishtinë 1982, f. 237.**

Vëllimi i tetë me krijimtari letrare popullore, Ninulla, të cilin e botoi Instituti Albanologjik i Prishtinës, është vëllimi i asaj pjese të poezisë që jeton e krijohet edhe sot. Është, pra, ajo poezi që bën jetë aktive me funksion të shquar në jetën dhe traditën e popullit tonë.

Ninulla nuk parashtron kërkesa që të dëgjohet, të pëlqehet dhe, më në fund, të refuzohet nga auditoriumi i gjerë, por i dedikohet foshnjës që akoma s'është aftësuar ta kuptojë këngën. Ninullën nuk e përcjellin instrumentet dhe meloditë vokale. Frymëzimi krijues i ninullës është „shtalb”, ai nuk këndon as për subjektet e dashurisë, as për personazhe të historisë. Por, me gjithatë, duhet të konstatohet se ninullat kanë vlera stabile artistike, përmbajnë porosinë etike e artistike dhe përbëjnë një zhanër të pasur brenda poezisë popullore lirike. Në melodinë e improvizuar të nënës, melodi që ngjan fort në recitim të zëshëm artistik, sepse harmonizohet me krismën e djepit, ninulla ka vazhduar të krijohet dhe është bërë fond i pasur i poezisë së llojit të vet që trajtojnë aspekte të shumta të jetës, të etnosit të popullit dhe, njësoj sikurse gjuha, janë njësi kombëtare.

Këngët e djepit si lloj i poezisë lirike jo vetëm me përmbajtjen, por edhe me praninë e tyre hapësinore e kohore, me aktualitetin shoqëror, kanë ruajtur përherë freskinë artistike. Në këtë mënyrë ato i kanë ikur monotonisë, kanë përmbushur misionin shoqëror e artistik krahas me dinamizmin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe kultural.

Ky lloj i poezisë, sikurse edhe disal loje të tjera, mbështet në parimin

e improvizimit. Ninulla ndjek përsosjen e ritmit, fjalët e bukura dhe dëshirat e vazhdueshme i shtojnë këtij ritmi dinamikën, e cila e mban të zgjuar kureshtjen e vlerësuesit. Nga ky aspekt, melodia e ninullës, gjatë interpretimit, bën që ndjenjat të derdhen spontanisht mbi atë krismën e djepit, duke i dhënë depërtim të fuqishëm ndjenjës së amës, e cila përtrin vatrën me njomëza.

Prandaj, gjithsesi duhet të konstatohet se kënga e parë, kënga që nis me lindjen, ndërthur në vete elemente të llojeve të tjera të poezisë popullore lirike. Kjo këngë është pikëfillimi i perspektivës së njeriut, prej ku me sy të prindit vështrohet me kujdes, dashuri, me dëshirë të pasosur për shëndet të mirë të fëmijës, për jetë të lumtur, për martesë me fat, për karakter të përsosur, për burrëri të rrallë, ose, nëse fëmija është femër — për jetë të çiltër e të dëlirë gruaje. Prej këtij pikëfillimi projektohet, natyrisht, me anë të imagjinatës, ardhmëria e familjes, e fisit — ardhmëria e popullit.

Vizioni si mjet i poetizimit, me anë të të cilit poezia shton vlerat komunikuese ndërmjet periudhave me distancë të dukshme kohore dhe vë lidhjet jetësore midis brezëve, është pajisja kryesore e ninullave, si poezi e parë, më e ngrohtë dhe më afër njeriut e, mbi të gjitha, si poezi e krijuar nga prindi që s'di të kursyer për fëmijën e vet.

Virtytet e njeriut që bazohen në traditën kanunore, por në ninulla, nxisin frymëzime edhe për llojet e tjera të këngëve popullore.

Ninullat janë këngë të vjetra. Ato që nga totemi e këndeje ruajnë në vete gjurmë besimesh të ndryshme, ku-